



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDI DHE AUDIOVIZUELE**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1, 10<sup>1</sup> dhe 13 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji për procedurën e përgjithëshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-100 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-100 datë 17.3.2023, dhe sipas Konkluzionit, ark.nr.02-1188/17 datë 21.3.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 11-të mbajtur më 21.3.2023, miratoi:

**AKTVENDIM**  
**për ndalim të procedurës së inicuar për heqje**  
**të lejes për transmetim në radio**

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO LA KOSTA SHPKNJP Vinicë, nr.08-93 datë 5.1.2015.

**A r s y e t i m**

Këshilli i Agjencisë në seancën e 9-të mbajtur më 8.3.2023, me Konkluzion, ark.nr.02-1007/9 datë 8.3.2023, miratoi propozimin e drejtorit të Agjencisë, dr.Zoran Trajčevski, PA1 nr.08-100 datë 7.3.2023 dhe inicioi procedure për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO LA KOSTA SHPKNJP Vinicë, nr.08-93 datë 5.1.2015, për faktin se pas mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-1002/1 datë 3.3.2023, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e primit të faturës së lëshuar nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, përkatësisht nuk ka paguar tarifën vjetore për leje për transmetim në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Në ligje me këtë, nga Agjencia më datë 9.3.2023 drejtuar transmetuesit të lartpërmendur i është dërguar Shkresë PA1 6p.08-100 datë 9.3.2023, për njoftim se nëse nuk paguan tarifën vjetore për lejen për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.

Megjithatë, më 14.3.2023 drejtuar drejtorit të Agjencisë, nga Sektori i Financave dhe Logjistikë, është dorëzuar Njoftim ark.nr.05-1002/2 datë 14.3.2023 që SHTR RADIO LA KOSTA SHPKNJP Vinicë, më 13.3.2023 ka kryer pagesë në shumë prej 7.987,00 (shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë) denarë, me të cilën transmetuesi e ka paguar plotësisht (në tërësi) tarifën vjetore për lejen për transmetim në radio.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1, 10 dhe 13 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104

Уп1 Бр.08-100

Скопје 22.03.2023 г.



Агенција за аудио и  
аудиовизуелни  
медиумски услуги

ул. Македонија бр.38  
1000 Скопје  
Република Северна  
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

[www.avmu.org.mk](http://www.avmu.org.mk)  
[www.avmu.mk](http://www.avmu.mk)  
[contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk)





**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

---

paragrafi (4) nga Ligji për procedurën e përgjithëshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 08-100 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-100 datë 17.3.2023, sipas Konkluzionit ark.nr.02-1188/17 datë 21.3.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 11-të mbajtur më 21.3.2023, vendosi ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele,  
Kryetari i Këshillit  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit aadministrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e prnimit të vendimit.

---

<sup>1</sup> Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shiko: nenin 8 nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).